

Çdo operator ekonomik që pretendon se i janë cenuar të drejtat ose interesat e ligjshme gjatë një procedure prokurimi ka të drejtë të paraqesë ankesë në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik. Ankesa paraqitet fillimisht pranë autoritetit kontraktor. Në rast se ankuesi nuk është dakord me vendimin e autoritetit kontraktor ose në rastet e parashikuara nga ligji, ai mund të ushtrojë të drejtën e ankimit pranë organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi.